LIGJ
Nr. 57/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8045, DATË 7.12.1995 "PËR NDËRPRERJEN E SHTATZËNISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8045, datë 7.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi "Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Shëndetësisë".

Neni 2

Në nenin 17, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:
"Gjobat vendosen nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.".

Neni 3

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 17/1
Inspektimi

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 4

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 18

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.".

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8016, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani